



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 79 Prot

Tiranë, më 16/06 2010

VENDIM Nr. 6 dt. 08.06.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 08.06.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me: Projekte të financuara nga donacione:


1. **Miratohet:** Projekt restaurimi Kalaja e Tiranës. (Delegacioni i Komisionit Europian)
2. **Miratohet:** Vlerësimi dhe zhvillimi i trashëgimisë materiale të Beratit. (Kala). (Delegacioni i Komisionit Europian). Projekti miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet:
 - *Supervizimi do të bëhet nga institucionet e specializuara IMK dhe ASHA, bazuar në legjislacion.*
 - *Të mos ndërhyhet në hyrje të kalasë. Të bëhet gërmim arkeologjik.*
 - *Çisterna e vjetër e ujit të pastrohet dhe të rivihet në funksion.*
 - *Në shkallare të vendosen tjegulla.*
3. **Miratohet:** Projekt mirëmbajtje kulla e Sahatit Elbasan. (Projekt me donacion privat, propozim i DRKK Tiranë). Projekti miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet:
 - *Të mos bëhet pastrim kimik i patinës.*
 - *Objekti të lyhet me bojën origjinale, e cila gjendet duke bërë një sondazh.*
 - *Të kontrollohet proçesi i oksidimit në mur nga përdorimi i hekurit.*
4. **Miratohet:** Restaurimi i infrastrukturës së Qendrës Historike, Shkodër. (Financim i KE), me vërejtjet e mëposhtme:
 - *Rruga të realizohet me pllaka monokrome dhe më të errëta se kunetat.*
 - *Ngjyra e gurit të stolave të jetë e njëjtë me atë të rrugës*

- *Gjelbërimi të jetë i ulët pa ndërhyrë në fasada dhe pa i dëmtuar.*
- *Ndriçimi të jetë tradicional dhe jo nga karrexhata.*
- *Sinjalistika rrugore të jepet me tabelat tradicionale*

I jepet e drejta IMK, nga ana profesionale, të miratojë edhe ndryshimet e tjera, që nuk ndryshojnë përmbajtjen, por që do të burojnë nga negociimet me Komisionin Evropian.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRAJ



SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE

